



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PROKURORIA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE

V E N D I M

“ Për pezullimin e çështjes penale nr. 1971 / 2007 “

Në Tiranë, sot më datë 12 nëntor 2007,

Unë Albert DEMIRNELI me detyrë Zv.Prokuror i Rrethit Tiranë, pasi studjova aktet e procedimit penal nr. 1971, të vitit 2007,

K O N S T A T O V A :

Se shtetësja Eleonora Bregu është drejtuese e Misionit fetar “Eleonorë” dhe banon brënda objektit të Kultit në Selitë të Vogël Tiranë. Natën në të gdhirë të mëngjesit të datës 24.05.2007, ajo pretendon se duke fjetur gjumë, 2 persona të maskuar, pasi kanë hyrë nëpërmjet dritares së dhomës së gjumit brënda këtij ambjenti, me force e kanë detyruar të pinte një lëng të helmuar dhe më pas janë larguar. Këtë veprim të tyre, ajo e ka shkruar në një letër, ku duke e ndjerë veten të pafuqishme, më pas ka rënë në një gjumë të thellë. Rreth ores 07:30 besimtarët e këtij misioni fetar kanë konstatuar se drejtuesja e tyre Eleonora Bregu nuk kishte dale si zakonisht. Rreth ores 09:30’ kur e bija e Eleonorës hyn në dhomën e gjumit të saj, konstaton se kjo e fundit ishte e zverdhur dhe mezi mbahej në këmbë. Nga biseda me Eleonorën, e bija Florida Duka meson se ajo ishte detyruar të pinte një lëng të helmatisur nga 2 persona të maskuar gjatë natës. Në këto kushte është vënë në dijeni policia gjyqësore e Komisarjatisë nr. 1 Tiranë, e cila ka kryer menjëherë të gjitha veprimet e para hetimore, si kqyrjen e vendit të ngjarjes, marrjen e mostrave të gjakut dhe urines për ekspertim, ekzaminimin e saj mjeko-ligjor, pyetjen e personave që kanë dijeni për rrethana të hetimit etj. Menjëherë pas kësaj ngjarje, Eleonora Bregu ka shkuar për t’u kuruar në një spital të Tuqrisë.

Mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisarjati i Policisë nr.1 Tiranë, më datë 28.05.2007, Prokuroria e Rrethit ka regjistruar procedimin penal nr. 1971, për krimin e “Vrasjes me dashje” mbetur në tentative, sipas nenit 76-22 të K.Penal.